




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Uprava za Zdravstvo i Socialnu Zastitu/Department of Health and Social
Welfare

Data/Datum/Date:	20.01.2025
Nr./Br./No	023
Për/Za/To:	Kryesuesin e Kuvendit, z. Adnan Ademi; Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Shtimes
Përmes/Preko/Through	Kryetari i Komunës, Dr. Qemajl Aliu
Nga/Od/From:	Drejtores e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, znj. Mimoza Salihu Qeriqi
Lënda/Predmet/Subject:	Propozim—vendim për mbulimin e shpenzimeve të varrimit në shumë prej 300€

Mbështetur në nenet 11, 12.2 pika (d) si dhe nenin 17 pika (k) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 5 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01/N-06/1636 të datës 03.09.2008, nenet 13.2 dhe 13.3 si dhe nenin 14.1 të Rregullores Komunale për Varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, me numër: Npi - 01/77 të datës 28.03.2019; Kuvendit të Komunës së Shtimes i paraqitet ky:

PROPOZIM-VENDIM
PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT NË SHUMËN PREJ 300 €

Kuvendi i Komunës së Shtimes do ta caktojë përmes këtij Vendimi çmimin në vlerë prej 300 euro për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për të gjithë qytetarët që varrosen në territorin e kufijve administrativë të Komunës së Shtimes.

Pagesa për qytetarët e komunitetit fetar Islam procedohet përmes Këshillit të Bashkësisë Islame - KBI në Shtime, mbi bazën e marrëveshjes dypalëshe që do të lidhet pas miratimit të këtij Vendimi.

Për qytetarët e komuniteteve të tjera fetare (ose ata që nuk i përkasin asnjë komuniteti fetar), pagesa e shpenzimeve të varrimit bëhet sipas kërkesës nga familjarët e personave që organizojnë varrimin.

Pagesa për shpenzimet e varrimit të veteranëve dhe invalidëve të Luftës së UÇK-së bëhet sipas nenit 14.4 të Rregullores me numër Nr. 01/77 të datës 28.03.2019 për Varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.